

## **Tregtia e Jashtme**

### **Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure (ESMS) INSTAT**

#### **Metadata Referenciale**

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave .....	2
3. Paraqitja statistikore.....	2
4. Njësia matëse .....	4
5. Periudha e referencës .....	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti .....	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia .....	6
11. Manaxhimi i cilësisë .....	7
12. Rëndësia.....	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria .....	9
15. Koherenca dhe Krahasueshmëria.....	9
16. Kostoja dhe ngarkesa .....	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor .....	10
19. Komente.....	12
Aneks .....	12

<b>1. Kontakt</b>	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Tregtisë së Jashtme, Turizmit dhe Transportit
1.3. Personi i kontaktit	Alma Mezini (Mara)
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Përgjegjëse sektori
1.5. Adresa postare	Blv. “Zhan d’Ark”, Nr.3 Tiranë, Shqipëri
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	amara@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
<b>2. Përditësimi i metadatave</b>	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	19/06/2017
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	19/06/2017
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	
<b>3. Paraqitja statistikore</b>	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave janë një instrument shume i rëndësishëm për marrësit e vendimeve në sektorët publik dhe privat. Ato ndihmojnë në përgatitjen e bisedimeve bilaterale dhe multilaterale ne kuadrin e politikave tregtare dhe për vlerësimin e ekonomive te tregut. Ato ndihmojnë kompanitë në studimin e tregut dhe në përcaktimin e strategjive të tyre tregtare.</p> <p>Këto statistikat kanë rendësi jo vetëm për këto marrëdhënie, por njëkohësisht janë një instrument i rëndësishëm për statistikat e tjera. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në statistikat e llogarive kombëtare, janë një element i rëndësishëm në Bilancin e Pagesave (BOP) etj.</p> <p>Statistikat e tregtisë së jashtme të mallrave kanë qëllim të japin të dhëna mbi tregtinë e mallrave, eksport-importin e mallrave në Shqipëri. Burimi kryesor i sigurimit të të dhënave statistikore të tregtisë së jashtme të mallrave është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Informacioni mblidhet çdo muaj, nëpërmjet Deklaratës Doganore. Kjo deklaratë siguron të dhëna të nevojshme, si për qëllime doganore, ashtu dhe për qëllime statistikore dhe mbledh të dhëna statistikore për periudhën e kryerjes së transaksionit, për llojin e mallit, peshën neto, peshën bruto, vlerën statistikore të mallit, vendin destinacion, vendin eksportues, vendin origjinë, tipin e transaksionit, llojin e koncesionit etj.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	Statistikat tregtisë së jashtme botohen në nivel vendi, sipas shteteve/grupe-shteteve, në nivel 2 shifror dhe të grupuara sipas 21-seksioneve dhe 9 grupe-

	<p>mallrave të Nomenklaturës së Kombinuar (NK):</p> <p><a href="http://www.instat.gov.al/media/166727/nomenklatura_e_kombinuar_e_mallrave_2012.pdf">http://www.instat.gov.al/media/166727/nomenklatura_e_kombinuar_e_mallrave_2012.pdf</a></p> <p>Statistikat e tregtisë së jashtme përpunojnë të dhënat e eksport-importit edhe sipas 9 grupeve të Klasifikimit Standard Ndërkombëtar i Tregtisë (SITC).</p> <p>Statistikat e tregtisë së jashtme përpunohen edhe sipas klasifikimeve të tjera (p.sh. Nomenklatura e Aktiviteteve Ekonomike, Nomenklatura e Produkteve, Klasifikimi sipas kategorive ekonomike) të përdorura për nevojat e sektorëve të tjerë në INSTAT dhe institucioneve të ndryshme.</p>
3.3. Mbulimi i sektorit	Përfshihen të gjithë sektorët që prodhojnë mallra tregtare.
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Përkufizimet kryesore të treguesve të përdorur dhe publikuar në statistikat e tregtisë së jashtme.</p> <p><b>Eksportet</b></p> <p>Këto janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor ose të përpunimit pasiv ose të ri-eksportuara pas përpunimit aktiv.</p> <p><b>Importet</b></p> <p>Këto janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë dhe të vendosura direkt ose qëndrojnë në magazina e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.</p> <p><b>F.O.B ( I lirë në bord)</b></p> <p>Një kusht i shpërndarjes së mallrave që tregon se çmimi i mallrave përfshin edhe shpenzimet e transportit dhe të dorëzimit tek një port i caktuar i ngarkimit.</p> <p><b>C.I.F. (Kosto,Sigurim,Transport)</b></p> <p>Një kusht i shpërndarjes së mallrave që tregon që çmimi i mallrave përfshin sigurimin dhe transportin deri tek një port i caktuar destinacion.</p> <p><b>Sistemi tregtar i përgjithshëm</b> regjistron të gjitha mallrat që hyjnë ose dalin nga territori ekonomik i një vendi, duke përjashtuar vetëm mallrat në transit. Pra në këtë rast regjistrohen si import të gjitha mallrat që hyjnë në magazinat doganore të një vendi, edhe në rast se nuk dalin në qarkullim të lirë në këtë vend. Në të njëjtën kohë të gjitha mallrat që dalin nga magazina doganore e një vendi regjistrohen si eksport i këtij vendi.</p> <p><b>Sistemi tregtar i veçantë</b> është koncept më i ngushtë. Në këtë rast të gjitha mallrat që hyjnë në magazinat doganore të një vendi nuk regjistrohen si import i këtij vendi. Këto mallra regjistrohen si import vetëm në rast se kalojnë në qarkullim të lirë në këtë vend ose vendosen nën procedure doganore për përpunim aktiv. Në mënyrë të ngjashme nuk regjistrohen si eksport të gjitha mallrat që dalin nga magazinat doganore.</p>

3.5. Njësia statistikore	Çdo person fizik dhe juridik që depoziton deklaratën doganore.
3.6. Popullata statistikore	Statistikat e tregtisë së jashtme regjistrojnë të gjitha mallrat, të cilat shtojnë ose pakësojnë burimet materiale të një vendi nëpërmjet hyrjeve (importeve) ose daljeve (eksporteve) nga territori ekonomik i tij, duke përfshirë edhe mallrat për përpunim. Informacion mbi mallrat jepet nga persona fizik ose juridik.
3.7. Zona e referencës	Statistikat e tregtisë së jashtme të mallra mbulojnë flukset tregtare që hyjnë ose dalin nga territori statistikor i Shqipërisë (nivel vendi).
3.8. Mbulimi në kohë	Seritë kohore të të dhënave vjetore të tregtisë në baza të qëndrueshme për shumicën e agregateve, janë të disponueshme elektronikisht që nga viti 1991. Seritë kohore të të dhënave mujore të tregtisë në baza të qëndrueshme për shumicën e agregateve, janë të disponueshme elektronikisht që nga viti 2005.
3.9. Periudha bazë	Indekset e vlerës njësi janë llogaritur duke përdorur si vit bazë vitin e mëparshëm.
4. Njësia matëse	Vlera e tregtisë shprehet në lekë; milion lekë. Pesha neto në kg dhe sasia në njësinë suplementare (psh. m, m <sup>2</sup> , numri i artikujve) përdoren për të matur volumin tregtar.
5. Periudha e referencës	Të dhënat për të cilat raportohet në këtë raport janë për vitin 2016. Periudha referuese për informacionin mbi të dhënat e tregtisë së jashtme është muaji kalendarik i eksportit / importit të mallrave. Në praktikë periudha e referencës është në përgjithësi muaji kalendarik gjatë të cilit është regjistruar deklarata doganore (data kur mallrat kalojnë kufirin / datën e strehimit) nga autoritetet doganore.
<b>6. Mandati institucional</b>	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Në nivel kombëtar, Statistikat e Tregtisë së Jashtme janë bazuar në: <ul style="list-style-type: none"> <li>Ligji Statistikor kombëtar Nr.9180 “Në Statistikat Zyrtare”, datë 05.02.2004, i ndryshuar, <a href="http://www.instat.gov.al/media/208100/statistical_law.pdf">http://www.instat.gov.al/media/208100/statistical_law.pdf</a></li> <li>Programin Kombëtar i Statistikave Zyrtare për periudhën 2017-2021, <a href="http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/programi-kombetar-i-statistikave-zyrtare.aspx">http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/programi-kombetar-i-statistikave-zyrtare.aspx</a></li> <li>Memorandumi i Mirëkuptimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave;</li> </ul> Në nivel Evropian, Statistikat e Tregtisë së Jashtme janë të bazuara në: <ul style="list-style-type: none"> <li>Rregulloren (KE) Nr 471/2009 të Parlamentit Evropian</li> <li>Rregullorja e Komisionit (KE) Nr 92/2010</li> <li>Rregullorja e Komisionit (KE) Nr 113/2010</li> </ul>
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Marrëveshja me Eurostat për të shpërndarë të dhënat e Tregtisë së Jashtme për Shqipërinë.
<b>7. Konfidencialiteti</b>	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura për tregtinë e jashtme konsiderohen reptehtësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr. 9180, datë 05.02.2004 "Për Statistikat Zyrtare", i ndryshuar, si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave

	<p>Personale". Neni15 i ligjit për statistikën zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit.</p> <p>Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.</p>
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	<p>INSTAT publikon të dhëna vetëm në nivelin e agreguara. Në mënyrë që të mbrohet identiteti i tregtarit, totali i publikuar duhet të përfshijë të paktën 3 tregtar në një qelizë, nga të cilët një tregtar nuk duhet të kalojë 85 % të vlerës totale.</p> <p>Vendim ndërkombëtar: Për mallrat e kapitullit 93 të NK, konfidencialiteti aktiv aplikohet direkt nga doganat: të gjitha kodet 8-shifrore të kapitullit 93 zëvendësohen me kodin NK 930000000 përpara se këto të dhëna të dërgohen INSTAT-it.</p>
<b>8. Politika e botimit</b>	
8.1. Kalendari i publikimeve	<p>Publikimi mujor i Tregtisë së Jashtme bëhet 17 ditë pas përfundimit të muajit referencë (T+17 ditë).</p> <p>Publikimi vjetor i Tregtisë së jashtme bëhet 110 ditë pas përfundimit të vitit (T+110 ditë)</p> <p>Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në kalendarin e publikimeve. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.</p>
8.2. Aksesimi në kalendarin e publikimeve	<p>Kalendari i publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT-it. <a href="http://www.instat.gov.al/al/publications/kalendari-i-publikimeve-2017,-instituti-i-statistikave.aspx">http://www.instat.gov.al/al/publications/kalendari-i-publikimeve-2017,-instituti-i-statistikave.aspx</a></p>
8.3. Aksesimi i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr 9180, datë 05.02.2004 “Mbi Statistikat Zyrtare”, i ndryshuar, statistikën zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias, INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individit, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta.</p> <p>Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin të dhënat e Tregtisë së jashtme janë si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Faqja Internetit</li> <li>• E-mail</li> <li>• Kërkesat e shkruara</li> <li>• Publikimet e Veçanta (Publikimet e përgjithshme të printuara, Tregtia Jashtme, Vjetari Statistikor)</li> <li>• Pjesa e info-s e dedikuar për të kontaktuar INSTAT <a href="http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/na-kontakttoni.aspx">http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/na-kontakttoni.aspx</a></li> </ul>

<b>9. Shpeshhtësia e shpërndarjes</b>	<b>Të dhënat e detajuara:</b> Mujore dhe vjetore; <b>Të dhënat e agreguara:</b> Mujore, tre mujore dhe vjetore;
<b>10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia</b>	
10.1. Njoftim për media	Njoftimet për media organizohen rregullisht në data fikse (dita e 17 e çdo muaji) në orën 11:00.
10.2. Publikime	<b>Publikimet e Statistikave të Tregtisë së Jashtme</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Mujore:</b> Tregtia e Jashtme</li> <li>• <b>Vjetore:</b> Ecuria e Tregtisë së Jashtme; Tregtia e Jashtme sipas Karakteristikave të Ndërmarrjes</li> </ul> <b>Publikime të Përgjithshme</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <b>Vjetore:</b> Shqipëria në Shifra; Vjetari Statistikor</li> </ul>
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Që nga viti 2011, përmes sistemit Pc-Axis, për përdoruesit e jashtëm në faqen e internetit ofrohet seria kohore e për Tregtinë e Jashtme mujore dhe vjetore. Gjithashtu në këtë faqe interneti ka një shpjegim të thjeshtë metodologjik. Bazën e të dhënave e aksesoni në linkun më poshtë: <a href="http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST">http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST</a>
10.4. Akses - Të dhënat mikro	Të dhënat mikro i jepen përdoruesve të veçantë pas plotësimit të formularëve standard. Këto të dhëna i jepen përdoruesve në rast se nuk janë konfidenciale bazuar në Ligjin e Statistikave Zyrtare Nr.9180, date 5.2.2004, Neni 15, i ndryshuar.  Në rast konfidenciali të dhënat fshihen në nivel të detajuar, që do të thotë se tregtari nuk lidhet me kodin ose partnerin real të produktit. Megjithatë është i përfshirë në tregtinë totale dhe në kapitullin e duhur. (në kodin e vërtetë HS2).
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike për Tregtinë e Jashtme nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linkun më poshtë: <a href="http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/na-kontaktoni.aspx">http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/na-kontaktoni.aspx</a>
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodologjinë mbi vrojtimin në linkun e mëposhtëm:  <a href="http://www.instat.gov.al/al/themes/tregtia-e-jashtme.aspx">http://www.instat.gov.al/al/themes/tregtia-e-jashtme.aspx</a>
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Statistikat e sektorit të Tregtisë së Jashtme, Turizmit dhe Transportit dokumenton gjithë procesin dhe procedurat për qëllimet e brendshme.

11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	<p>INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “PËR STATISTIKAT ZYRTARE, Nr.9180, datë 05.02.2004”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.</p>
11.2. Vlerësimi i cilësisë	<p>Proceset janë në gjendje për të monitoruar në mënyrë adekuate cilësinë e statistikave të përpiluara dhe të shpërndara. Njësia ndërmerr rregullisht kontrolle për mbulimin, klasifikimin dhe mungesën e të dhënave. Përveç kësaj, ai monitoron konsistencën e brendshme të të dhënave burimore dhe qëndrueshmërinë në të gjitha burimet e të dhënave. Vlerën dhe heton të gjitha lëvizjet e pazakonta në të dhënat burimore të marra.</p>
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e të dhënave të tregtisë si përdorues të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përdoruesit e jashtëm: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Institucione të administratës publike</li> <li>○ Universitetet</li> <li>○ Organizatat jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare</li> <li>○ Bizneset</li> <li>○ Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme.</li> </ul> </li> </ul> <p>Disa nga treguesit më të rëndësishëm i dërgohen Komisionit Evropian, Bankës Botërore; FMN-ja; OKB-ja etj.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Me përdorues të brendshëm nënkuptohen sektorë të tjerë brenda INSTAT të cilët përdorin rezultatet e tregtisë së jashtme si input në punën e tyre: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Drejtoria Llogarive Kombëtare</li> <li>○ Drejtoria e Bujqësisë</li> <li>○ Sektori i Statistikave Afatshkurta</li> <li>○ Regjistri Strukturalor i Ndërmarrjes</li> </ul> </li> </ul>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Aktualisht nuk ka një matës të kënaqësisë së përdoruesve nga publikimet e INSTAT. Page Views (Klikime) në lidhje me Tregtinë e Jashtme për vitin 2016 janë rreth 21,309 klikime. Page Views (Klikime) në lidhje me Tregtinë e Jashtme për vitin 2015 janë rreth 19,660 klikime.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënave të Tregtisë së Jashtme për vitin 2016 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të rregulloreve të ndjekura.</p> <p>Shkalla e plotshmërisë të të dhënave, për Tregtisë së Jashtme për vitin 2016, është 87.5%. Kjo përlllogaritja ka marr në konsideratë Neni 2 Prodhimi i statistikave</p>

	Europiane në importin dhe eksportin e mallrave.
<b>13. Saktësia dhe besueshmëria</b>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Burimi i vetëm i gabimeve është keqinformimi i bërë nga tregtari në doganë. Sapo tregtari vëren një gabim, ai mund ta korrigjojë atë thjesht me një deklaratë plotësuese. Këto korrigjime pasqyrohen në të dhënat nga INSTAT sa më shpejt të jetë e mundur. Ndikimi i këtyre korrigjimeve në variabla është shumë i vogël.
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Të dhënat e tregtisë së jashtme mblidhen nga burime administrative prandaj nuk ka gabime kampionimi.</p> <p>Kontrollet e cilësisë të aplikuara nga INSTAT për të identifikuar gabimet në fushat në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shënimet me Kodin e Procedurës Doganore Kombëtare të inicializuara me 'ANU' fshihen pasi ato korrespondojnë me një anulim: është një fazë e ndërmjetme para se statusi 'i anuluar' ti atribuohet artikullit.</li> <li>• Shfuqizohen rekordet me kodet e procedurës doganore duke filluar nga 65 (ri-importimi i mallrave të riparuar), 93 (shkatërrimi i mallrave) dhe 99 (humbjet natyrore ose teknike).</li> <li>• Fushat e kodeve: Nomenklatura e kombinuar 8-shifrore, kodet e procedurës doganore, kodet e procedurës doganore kombëtare, kushtet e dorëzimit, kodi i zyrës, mënyra e transportit, kontejneri, vendi, njësia suplementare, tregtari, preferenca, kuota, valuta.</li> <li>• Kodi i NK duhet të jetë në përputhje me Nomenklaturën zyrtare të Kombinuar të vitit.</li> <li>• Partneri nuk mund të jetë Shqipëria përveç deklarimit me CPC '7200', '9600' (hyrja pa taksa) dhe '6910' (Ri-importi i mallrave të eksportuara).</li> <li>• Kushtet e dorëzimit nuk duhet të jenë asnjëherë bosh.</li> <li>• Energjia elektrike ('2716000000') nuk mund të lidhet me një mënyrë tjetër transporti përveç '7. Instalime fikse të transportit '.</li> <li>• Kontrollet e arit monetar në lidhje me kodin CN' 71082000: 'Nëse kodi 71082000 i referohet një sasia të madhe dhe tregtari është BSH, atëherë ajo duhet të përjashtohet nga ITGS, por të përfshihet në të dhënat e dërguara në BSH. Përndryshe ka shumë mundësi të jetë një gabim dhe kodi i mallrave duhet të ndryshohet në ari jo-monetar</li> <li>• Kodi preferencës nuk është i vlefshëm mbas 2011 ("MTLYU", "SPA_BE", "MTLRO", "MTLKS")</li> <li>• Dogana duhet të vendosë gjithmonë të njëjtën sasi me kodin e caktuar NK, përndryshe bashkimi i deklaratës nuk do të ketë kuptim për sasinë e SU. Më pas zbatohen testet e mëposhtme: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Sasia e SU që gjendet në deklaratë është në SU e kërkuar për kodin NK.</li> <li>○ Sasia në SU nuk duhet të plotësohet nëse nuk kërkohet nga NK.</li> <li>○ Nëse fusha e sasisë e SU nuk është e bosh, kodi SU duhet të plotësohet.</li> <li>○ Nëse plotësohet kodi SU, atëherë sasia nuk duhet të jetë 0.</li> </ul> </li> <li>• Pesha neto dhe sasia në njësinë suplementare, nuk mund të jenë të dyja</li> </ul>



	<p>të barabarta me 0.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pesha neto nuk duhet të jetë më e madhe se pesha bruto.</li> <li>• Vlera statistikore duhet të jetë mbi 0 kur procedura doganore është e ndryshme nga '7200', '9600' ((Hyrja pa taksë) dhe '6910' (ri importimi i mallrave të eksportuara) pasi vlera mund të jetë 0 për të shmangur numërimin e dyfishtë me deklaratën e lidhur)</li> </ul>
13.3. Gabim jo i kampionimit	Nuk ka gabime të jo- kampionimit. Burimet e mundshme të gabimeve të jo-kampionimit përfshijnë klasifikimet e gabuara të kodeve të mallrave, mos përgjigjen, përgjigjen e vonë etj.
<b>14. Afatet kohore dhe përpikmëria</b>	
14.1. Afatet kohore	Të dhënat mujore 17 ditë pas periudhës referuese. Ky raport i referohet të dhënave të viti 2016.
14.2. Përpikmëria	<p>Shpërndarja e të dhënave kryhet në përputhje me kalendarin e statistikave të tregtisë së jashtme që INSTAT prodhon dhe publikon çdo vit. <a href="http://www.instat.gov.al/al/publications/kalendari-i-publikimeve-2017,-institut-i-statistikave.aspx">http://www.instat.gov.al/al/publications/kalendari-i-publikimeve-2017,-institut-i-statistikave.aspx</a></p> <p>Publikimet e Tregtisë së Jashtme kanë qenë të përpikta në kohë në <b>100%</b> të publikimeve të nxjerra gjatë viteve.</p>
<b>15. Koherenca dhe Krahasueshmëria</b>	
15.1. Krahasueshmëria gjeografike	Dallimet ndërmjet metodologjisë, koncepteve dhe përkufizimeve të përdorura për të mbledhur dhe përpunuar të dhënat mund të ndikojnë në krahasimin e të dhënave mes Shqipërisë dhe vendeve të tjera
15.2. Krahasueshmëria kohore	Gjatë viteve ka shumë ndryshime në lidhje me përkufizimet, mbulimet apo metodat, klasifikimet. Këto ndryshime ndikojnë në krahasueshmërinë me kalimin e kohës, veçanërisht në nivel të detajuar në rastin e ndryshimeve në klasifikim. INSTAT rishikon të dhënat çdo muaj, dhe në rast të ndryshimeve të rëndësishme rishikon të dhënat e mëparshme.
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	INSTAT është institucioni zyrtar që publikon statistikat e tregtisë së jashtme, bazuar në ligjin e statistikave.
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave, kontrollohet para se të finalizohet. Kontrollohen lidhjet ndërmjet variablave dhe konfirmohet koherenca ndërmjet serive të ndryshme të të dhënave.

<p><b>16. Kostoja dhe ngarkesa</b></p>	<p>Duke pasur si burim unik burimin administrativ, ngarkesa mbi të anketuarit është pothuajse zero.</p> <p>Personat që punojnë me të dhënat statistikore të Tregtisë së Jashtme janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Stafi gjithsej në zyrat qendrore: 2 të punësuar;</li> </ul>
<p><b>17. Rishikimi i të dhënave</b></p>	
<p>17.1. Politika e rishikimit</p>	<p>Politikat e rishikimit të Tregtisë së Jashtme bëhet në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni:</p> <p><a href="http://www.instat.gov.al/media/371719/politika_e_revizionimit.pdf">http://www.instat.gov.al/media/371719/politika_e_revizionimit.pdf</a></p> <p><a href="http://www.instat.gov.al/media/371533/politika_e_trajtimit_te_gabimeve.pdf">http://www.instat.gov.al/media/371533/politika_e_trajtimit_te_gabimeve.pdf</a></p>
<p>17.2. Praktika e rishikimit</p>	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Doganave(DPD) u ofron autoritetet statistikore kombëtare të dhënat e rishikuara për importin dhe eksportin, ku të dhënat statistikore tashmë të ofruara janë ndryshuar. Sektori i statistikave të tregtisë së jashtme rishikon të dhënat çdo muaj dhe rishikimet publikohen në botimin e ardhshëm. Të dhënat përfundimtare për vitin botohen në botimin vjetor, të Statistikave të Tregtisë së Jashtme, të vitit të ardhshëm. Rishikimet e bëra çdo muaj pasqyrohen jo vetëm në botime, por në të njëjtën kohë pasqyrohen dhe në bazën e të dhënave në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.</p>
<p><b>18. Përpunimi statistikor</b></p>	
<p>18.1. Burimi i të dhënave</p>	<p>Burim i vetëm për të dhënat e tregtisë së jashtme janë autoritet doganore. Mallrat e mbuluara nga Dogana përfshijnë energjinë elektrike dhe naftën bruto. Transporti i gazit apo ujit me tubacione nuk janë subjekt i tregtisë ndërkombëtare në Shqipëri. 'Anijet' dhe 'aeroplanët' janë të përfshira në statistikat e tregtisë së jashtme të bazuar në deklaratën doganore. Për momentin INSTAT nuk përdor ndonjë burim tjetër.</p>
<p>18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave</p>	<p>Të dhënat e Tregtisë së Jashtme mblidhen çdo muaj nga burime administrative.</p>
<p>18.3. Grumbullimi i të dhënave</p>	<p>Drejtoria e përgjithshme e doganave është përgjegjëse për mbledhjen dhe kontrollin e deklaratave doganore. Të dhënat mblidhen elektronikisht nga zyrtarët e doganës. Për qëllime statistikore këto të dhëna i dërgohen çdo muaj INSTAT-it, për kontroll dhe përpunim të dhënash. Të dhënat e përkohshme mujore i jepen INSTAT-it çdo muaj në 18 të muajit pasardhës, për muajin referues. Të dhënat kontrollohen dhe njoftimi botohet rreth datë 25, në letër dhe në faqen e internetit. Në qershor, të dhënat përfundimtare të përditësuar në lidhje me dymbëdhjetë muajt e vitit të kaluar dërgohen nga Dogana. Rishikimi i fundit publikohet nga INSTAT në tetor. Të dhënat jepen aktualisht në format excel në CD (me postë). Nuk ka vonesa në dërgesën e të dhënave.</p>

<p>18.4. Vlefshmëria e të dhënave</p>	<p>Përpunimi i të dhënave bëhet me një program të veçantë (Eurotrace) për përpunimin e të dhënave të tregtisë së jashtme të përdorura edhe në vendet e tjera të Europës.</p> <p>Në programin (Eurotrace) janë të vendosura disa kontrolle vlefshmërisë gabimesh, për shembull: Kontrollat në lidhje me vlerën e mallrave që duhet të jetë &gt;0, pesha neto&lt;pasha bruto, vendi partner nuk duhet të jetë Shqipëria (AL), kontrolle për kode specifike që duhet të analizohen, njësia e produkteve duhet të jetë e njëjtë me njësinë e vendosur nga Dogana në NK, nuk duhet të ekzistojë njësia në qoftë se nuk është përcaktuar në NK, sasia duhet të jetë &gt;0 nqs ka të përcaktuar njësinë, korigjime të kodeve të produkteve ose shteteve sipas standardeve të Eurostat, etj.</p>
<p>18.5. Përpilimi i të dhënave</p>	<p>Që nga marsi 2012, sistemi Eurotrace është implementuar dhe janë vendosur disa kontrolle bazë të të dhënave. DPD kryhen disa kontrolle të të dhënave por jo për qëllime statistikore. Këto kontrolle bëhen për qëllime tatimore kështu që të dhënat e marra kanë disa gabime vlefshmërisë që korigjohen nga INSTAT-i.</p> <p>Dogana llogarit vlerë statistikore FOB për eksportet; dhe për importin, kur vlera statistikore është e nënvlerësuar në krahasim me vlerat e dhëna në tabelat e referencës, nëpunësit doganorë aplikojnë një normë rregulluese për të rritur vlerën doganore. Vlera e rregulluar përdoret si vlerë statistikore duke qenë se është më afër realitetit.</p> <p>INSTAT nuk ka një rutinë të rregullt për vlerësimin e vlerës statistikore. Nëse vlera statistikore mungon INSTAT kontakton me doganën për të korigjuar dhe vendosur vlerën. Në rast se Dogana nuk përgjigjet në vlerësojmë vlerën duke përdorur çmimin mesatar të produktit.</p> <p>Të dhëna statistikore nuk përfshin natyrën e transaksionit. Dogana është duke hetuar se si ta mbledh këtë të dhënë pasi ky informacion është kërkuar nga disa institucione. Deri tani, nuk është gjetur asnjë mënyrë për të mbledhur këtë të dhënë në sistemin aktual.</p> <p>DPD nuk zbaton thjeshtimin. Transaksionet regjistrohen duke përdorur deklaratat doganore dhe të dhënat përdoren në statistika.</p> <p><b>Mallrat e Veçantë:</b></p> <p><b>Bimët industriale</b></p> <p>DPD nuk përdor procedura thjeshtimi për bimët industriale. Transaksionet regjistrohen sipas kodeve përkatëse të NK.</p> <p><b>Anijet dhe aeroplanët</b></p> <p>INSTAT përfshin ‘Anijet’ dhe ‘Aeroplanët’ në të dhënat e tregtisë së jashtme bazuar në deklaratat doganore.</p> <p><b>Mjetet motorrike dhe pjesët e aeroplanëve</b></p> <p>INSTAT përfshin ‘Mjetet motorrike dhe pjesët e aeroplanëve’ në të dhënat e</p>

	<p>tregtisë së jashtme bazuar në deklaratat doganore.</p> <p><b>Mallrat e dërguara në anije dhe aeroplanë</b></p> <p>Mallrat e dërguara në anije dhe aeroplanë konsiderohen si eksport normal.</p> <p><b>Produktet e detit</b></p> <p>Produktet e detit konsiderohen si eksport normal.</p> <p><b>Energjia elektrike dhe gazi</b></p> <p>INSTAT përfshin 'Energjinë elektrike' në të dhënat e tij. Të dhënat merren çdo muaj nga DPD. Për momentin tregtia e energjisë elektrike dhe gazit (grupi 271112) regjistrohet nga doganat dhe merret parasysh në tregtinë e Shqipërisë.</p> <p><b>Mallrat ushtarake</b></p> <p>Nuk ka procedura të veçanta në Doganë për të deklaruar mallrat nën sekretin ushtarak. Konfidencialiteti në nivel kombëtar aplikohet nga Dogana para dërgimit të të dhënave të INSTAT duke zëvendësuar të gjitha kodet e mallrave që i përkasin kapitullit NK 93 me kodin NK 93000000. Ky konfidencialiteti është i bazuar në një vendim të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.</p>
18.6. Rregullimi	Nuk ka rregullime të bëra në të dhënat e Tregtisë së Jashtme.
19. Komente	
<b>Aneks</b>	